



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS  
DHE ENERGJISË

**KOMISIONI I DHËNIES SË KONCESIONIT/ PARTNERITETIT PUBLIK PRIVAT**

Nr \_\_\_\_\_ Prot

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**SQARIME MBI DOKUMENTET E GARËS**

Autoriteti Kontraktues, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, pas kërkesës së disa operatorëve ekonomikë mbi sqarime për dokumentet e procedurës së koncesionit/ partneritetit publik privat, me objekt “Dhënie me koncesion/PPP për projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Aeroportit të Vlorës” me Nr. Reference REF-46571-12-19-2019, publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, në mbështetje të ligjit nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat” të ndryshuar, ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, sqaron operatorët ekonomikë në lidhje me kërkesat e tyre si edhe pa identifikuar burimin e kërkesës, ia komunikon sqarimin përkatës të gjithë operatorëve të tjerë ekonomikë të interesuar.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nxit të gjithë operatorët ekonomikë kombëtarë dhe ndërkombëtarë të interesuar për të paraqitur çdo kërkesë për sqarim e cila lidhet me aspektet teknike të procedurës së koncesionit, në kompetencë të trajtimit nga kjo e fundit si edhe të cilat nuk lidhen me kuadrin ligjor në përgjithësi dhe/ ose raste të cilat qartësisht dhe pa ekuivok janë pasqyruar në dokumentet e garës koncesionare.

**PYETJE**

1. Bazuar në një shqyrtim të kujdesshëm të dokumentacionit të tenderit të përcaktuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, parametrat e `Modelit Financiar të përdorura

nga Ministria për Studimin e Fizibilitetit të Aeroportit nuk janë të qarta. Ju lutemi të përcaktoni parametrat e Modelit Financiar që janë përdorur në këtë Projekt.

## **PËRGJIGJE**

Sqarojmë se në studimin e fizibilitetit autoriteti kontratkues ka publikuar të gjithë të dhënat e nevojshme mbi të cilat operatorët ekonomikë pjesëmarrës mund të ndërtojnë dhe propozojnë planin e tyre të biznesit.

## **PYETJE**

2. Dokumentet e tenderit 2.3 Kapaciteti teknik, pika 4 Përvoja në kontraktim; Përcaktohet se Ofertuesi, ose, nëse Ofertuesi është Bashkim Shoqërisht, një prej Pjesëtarëve duhet të provojë kapacitetin teknik sa i përket:
  - a. Rinovimit të 10 (dhjetë) pistave gjatë 10 (dhjetë) vitet të fundit.
  - b. Ndërtimit të të paktën 2 (dy) Terminaleve gjatë 10 (dhjetë) viteve të fundit.
  - c. Rinovimit / zgjerimit të 10 (dhjetë) Terminaleve gjatë 10 (dhjetë) viteve të fundit.
  - d. Ndërtimit të të paktën 2 (dy) Kullave të Kontrollit të Trafikut Ajror gjatë 10 (dhjetë) viteve të fundit.  
A mund të sqaroni nëse ofertuesi duhet të përmbushë të gjitha pikat e mësipërme (a,b,c dhe d) apo mjafton vetëm përmbushja e njëres prej tyre?  
Gjithashtu, a ka një numër minimal kontratash të kërkuara për sa i përket përvojës në shërbimet e rinovimit?

## **PËRGJIGJE**

Në lidhje me pyetjen e parë autoriteti kontraktues sqaron se kriteri i mësipërm është kumulativ (operatori ekonomik duhet të përmbushë të katër pikat e mësipërme) për rrjedhje duhet të lexohet, interpretohet dhe plotësohet si një i vetëm.

Në lidhje me pyetjen e dytë, sqarojmë se nuk parashikohet një numër minimal kontratash, por me anë të kontratës/kontratave operatori ekonomik duhet të dëshmojë se përmbush kushtin/tet e mësipërme.

## **PYETJE**

### 3. Shtojca 8 “Mbi disponimin e makinerive”

Vërejmë se ne dokumentet e tenderit është lënë e pandryshuar ose pa koment shtojca 8 “Mbi disponimin e makinerive”. Kjo shtojce është tipike për një kontratë sipërmarrje për punime ndërtimi por zbatimi i saj për një vepër si aeroporti që pjesën madhore të vlerës e ka në fazën post-ndërtimit, ngelet i paqartë. Për më tepër kjo shtojce ka kërkesa që mund të plotësohen nga një shoqëri të së drejtës shqiptare, i cili ka pajisjet dhe i ka të regjistruara sipas kërkesave të legjislacionit shqiptar (regjistrim, leje etj.). Duke patur parasysh kompleksitetin e veprës që do të ndërtohet, kohëzgjatjen dhe mbi të gjitha fazën post- konstruksion, do të donim të sqaroheshim nëse lenia e kësaj shtojce ka qene e qëllimtë. Nëse po çfarë pritshmëri ka autoriteti kontraktor për makineritë që duhet të disponohen, dhe për çfarë afati pritet ky disponibilitet dhe si duhet të paraqiten nga një operator i huaj.

## **PËRGJIGJE**

Autoriteti kontraktues sqaron se referuar dokumenteve të garës nuk kërkohet të provohet disponueshmëria e mjeteve dhe pajisjeve të nevojshme për realizimin (ndërtimin civil) e kontratës. Kjo është lënë në vlerësim të operatorëve ekonomikë.

## **PYETJE**

### 4. Pasqyrat financiare të audituara

Në kriteret e veçanta të kualifikimit në seksionin 2.2 kërkohet si vijon: *Dokumentet që provojnë burime të mjaftueshme financiare përfshijnë: Kopje të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit (2016, 2017 dhe 2018), të paraqitura në administratën tatimore, Raportet e auditimit financiar, (përfshirë opinionin e auditorit), të certifikuara nga një subjekt i jashtëm i licencuar auditimit.*

Lutem të na informoni nëse do të pranohen si të vlefshme pasqyrat financiare dhe raportet e auditimit të publikuara në faqet zyrtare të operatoreve pjesëmarrës, të cilat nuk mbartin firme dhe vule. Lutem mbani parasysh që këto dokumente publikohen se bashku me raportin e audituesit që në shumicën e rasteve është një shoqëri Big4 e auditimit (Deloitte, PwC, E&Y, KPMG). Në kushte që këto dokumente janë publike dhe janë online nuk mund të paraqitet një kopje e noterizuara e tyre por thjesht një fotokopje me vulën e shoqërisë (nëse ka të tillë) dhe linku përkatës ku mund të certifikohet vërtetësia e tyre nga autoriteti kontraktor.

## **PËRGJIGJE**

Autoriteti kontraktues sqaron se në zbatim të dokumenteve të procedurës së konkurrimit, të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim. Sqarojmë se në dokumentet e procedurës konkurruese është sqaruar qartësisht mbi natyrën e dokumentacionit që duhet të dorëzohet në drejtim të përmbushjes së kapacitetit ekonomik dhe financiar si edhe formën e dorëzimit të tyre.

## **PYETJE**

5. Afati i dorëzimit të ofertave. Në kushtet kur afati i dorëzimit të ofertave po afron shpejt dhe tek partneret Evropiane dhe aziatike është rritur thellësisht shqetësimi i udhëtimit për shkak të përhapjes së shpejtë të koronavirusit. Kjo e ka bërë pothuajse të pamundur vizitat e partnerëve për të vlerësuar të gjitha kushtet teknike për ndërtimin e aeroportit, ne do të donim të kërkonim një shtyrje të paktën një javore për ti dhënë pak më tepër kohë vendosjes së virusit në kontroll dhe lëvizjes me të kollajte të ekspertëve. Sipas udhëzimeve nga OBSH pritshmëria është që ne muajin maj do të ketë një situatë të kontrolluar të virusit.

## **PËRGJIGJE**

Në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, sqarojmë se procedura e dhënies së koncesionit/ppp zhvillohet me mjete elektronike si edhe i gjithë informacioni i nevojshëm përfshirë edhe video dhe materialet e tjera mbështetëse dhe sqaruese janë në vënë në dispozicion në formë elektronike. I gjithë dokumentacioni dorëzohet online në Sistemin e Prokurimeve Elektronike.

Çdo sqarim i bërë sa më sipër është i bazuar në ligjin 125/ 2013 “Për koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat” të ndryshuar, aktet nënligjore në zbatim të tij dhe dokumenteve të procedurës konkurruese.

## **KOMISIONI I DHËNIES SË KONCESIONIT/ PARTNERITETIT PUBLIK PRIVAT**